



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C (rusisht)

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë seminare;

Viti akademik: 2024 – 2025 , Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës së UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJA DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë ka si qëllim të përgatisë studentët për të komunikuar në nivel të avancuar në gjuhën ruse dhe për të kuptuar thellësisht kulturën dhe historinë e Rusisë. Zhvillon aftësitë e studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive në situata të ndryshme, përfshirë biseda, shkrimin e teksteve të ndryshme, dhe interpretimin. Studenti duhet të jetë i aftë të kalojë nga një nivel më i ulët në nivelin pasardhës më të lartë në zotërimin e gjuhës ruse.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të aftësojë studentët në përdorimin e avancuar të gjuhës ruse, në të folur dhe të shkruar, duke respektuar normat leksikore, gramatikore dhe stilistike.
- 2.Të zhvillojë aftësinë për të analizuar, interpretuar dhe diskutuar tekste letrare dhe kulturore në gjuhën ruse, duke përfshirë kontekstin historik dhe kulturor të tyre.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Lënda synon zotërimin praktik të gjuhës ruse, si dhe pajisjen e studentëve me aftësitë dhe shprehjet komunikative bazë (leximi, dëgjim, të folur, shkrim) brenda disa tematikave të njohura dhe mbi bazën e materialit leksiko-gramatikor të përvetësuar.
2. Studentët në fund të kursit do të jenë i aftë të përmirësojë të shprehurin me shkrim, me gojë, si dhe aftësinë e argumentimit të situatave të ndryshme. Gjithashtu, do të mësojnë më shumë për historinë, kulturën dhe letërsinë ruse. Ata do të zhvillojnë aftësinë për të analizuar dhe interpretuar tekste të rëndësishme në gjuhën ruse, duke përfshirë veprat letrare të autorëve rusë